



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 117 prot.

Kamëz, më 17.9 .2021

V E N D I M

Nr. 95 Datë 17/9 2021
PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORËT SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 17.09.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.83 Datë 14.09.2021** mbështetur në Ligjin 57, datë 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM nr. 956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore”; Kreun IV, pika 2, të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar; Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, të ndryshuar; Kreun IV, pika 3, të VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. dhe në VKB nr 158 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së **muajit GUSHT 2021, prej 41 familjeve** që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë, për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është **145,340 (njëqind e dyzetë e pesëmijë e treqind e dyzetë) lekë.**
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz Tel: 355 47 200 177 E-mail: keshilli.bashkiak@kamzo.gov.al, web: www.kamzo.gov.al